



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROJEKTIMIT URBAN

LENDË: RELACION I GJENDJES EKZISTUES DHE PUNIMET QE DO TE KRYHEN

Sipas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar me Prot. **nr. 532** date **02.02.2026**, kërkesës me Prot. **1082** date **27.02.2026**, kërkesës me Prot. **3034** date **26.05.2026** dhe kërkesës me Prot. **4317** date **29.07.2026** "Kërkesë për hartim preventivi", sipas kërkesave të cituara për secilin objekt arsimor, pas verifikimeve të kryera në terren, u hartua projekti teknik dhe preventivi i punimeve.

- **1.Shkolla 9-vjeçare "Qemal Haxhihasani"** ndodhet në Njësinë Administrative Nr.5, në lagjen "11 Nentori", rruga "Kostaq Cipo" të qytetit të Elbasanit. Hyrja kryesore e shkollës është në anën veriore të rruges. Shkolla është 4 kate e ndërtuar me konstruksion tulle me soleta monolit. Sipas kërkesës së Qendrës Ekonomike të Arsimit kerkohet rikonstruksioni i plote i tualeteve ku nga verifikimet e kryera në terren gjëndja aktuale e tyre rezulton:



Foto të gjëndjes ekzistuese të tualeteve



PUNIMET QE DO TE KRYHEN

- Për nevojat e ndërhyrjes së rikonstruksionit të plote të tualeteve të shkollës për secilin kat të saj janë parashikuar punimet si me poshte :
 - **Punime prishje** qe konsistojnë në:
 - ❖ prishje suvatimi.
 - ❖ heqje dhe zëvendësimi i pllakave të dyshemesë dhe të tualeteve.
 - ❖ zëvendësimin e dyerve të brendshme të drurit të tualeteve në dyer duro/plastik me mbushje ku: do të hiqen kanatat e dyerve të drurit pa i dëmtuar ato, heqja e kasës së dërrases pa e dëmtuar (thyer) për ato dyer që ka mundësi dhe vendosja e sistemimi në vendin e caktuar nga bashkia Elbasan, do të bëhet suvatimi i shpatullave të dyerve si dhe patinimi i ketyre shpatullave, do te vendosen dyert duro/plastik te mbushura.
 - ❖ heqjen e ëc allaturka dhe lavamaneve pasi jane te demtuara dhe zevendesimin e tyre.

➤ **Punime rikonstruksioni** që konsistojnë në:

- ❖ Punime suvatimi dhe veshje .
- ❖ Punime shtresash që konsistojnë në shtrimin me pllaka të dyshemese dhe veshjen me pllaka të mureve perimetrale deri në lartësinë 1.8m .
- ❖ Vendosja e dyerve d/alumin dopio xham.
- ❖ Hidroizolimi i tualeteve për të mos pasur lagështi.
- ❖ Lyerja me bojë hidroplastike .

➤ **Punime hidrosanitare**

- ❖ Instalimet e reja hidrosanitare sipas kushteve teknike me materiale bashkohore duke i përshtatur sipas projektit të paraqitur.

- **2."Shkolla Europa",** ndodhet në fshatin Katund i Ri, në Njësinë Administrative Bradashesh , te qytetit te Elbasanit. Shkolla është 3 kate e ndertuar me konstruksion betonarme dhe i mbuluar me çati.



Foto të shkolles Europa

Sipas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar kërkohet vendosja e sistemit të ulluqeve për kullimin e ujërave atmosferikë. Nga verifikimi në terren rezulton:



Foto të gjëndjes ekzistuese





Foto të gjëndjes ekzistuese

PUNIMET QE DO TE KRYHEN

- Per nevojat e nderhyrjes për furnizimin dhe vendosjen e ulluqeve horizontale dhe tubave vertikalë për grumbullimin dhe largimin e ujërave atmosferikë nga çatia, sipas kushteve teknike të zbatimit, për objektin jane parashikuar punimet si me poshte :
 - Vendosje ulluk shkarkimi vertikal xingato
 - Vendosje ulluk shkarkimi horizontal xingato
 - Prishje suvatimi te pjeseshme
 - Suvatim i ri
 - Trasport te mbeturinave ndertimore

- **3."Shkolla Adem Krasniqi"**, ndodhet në lagjen Skënderbej, në Njësinë Administrative Nr.3 , te qytetit te Elbasanit. Shkolla eshte 2 kate e ndertuar me konstruksion betonarme dhe e mbuluar me çati.



Foto të shkolles Adem Krasniq

-Sipas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar kërkohet kërkohet vendosja e sistemit të ulluqeve për kullimin e ujërave atmosferikë. Nga verifikimi në terren rezultoi:



Foto të gjëndjes ekzistuese



Foto të gjëndjes ekzistuese

PUNIMET QE DO TE KRYHEN

- Per nevojat e nderhyrjes për furnizimin dhe vendosjen e ulluqeve horizontale dhe tubave vertikalë për grumbullimin dhe largimin e ujërave atmosferikë nga çatia, sipas kushteve teknike të zbatimit, për objektin jane parashikuar punimet si me poshte :
- Vendosje ulluk shkarkimi vertikal xingato
- Vendosje ulluk shkarkimi horizontal xingato
- Prishje suvatimi te pjeseshme
- Suvatim i ri
- Trasport te mbeturinave ndertimore

- **4. "Shkolla Luigj Gurakuqi"**, ndodhet në lagjen Luigj Gurakuqi, në Njësinë Administrative Nr.1, të qytetit të Elbasanit. Shkolla është 3 kate e ndërtuar me konstrukcion tulle me soleta monolit.



Foto të shkolles Luigj Gurakuqi

-Sipas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar kërkohet heqja e pllakave ekzistuese të dëmtuara dhe vendosja e pllakave të reja në ambientet e klasave, ku disa prej të cilave do të shtrohen pjesërisht.

Nga verifikimi në terren rezulton:






Foto të gjëndjes ekzistuese

PUNIMET QE DO TE KRYHEN

- Per nevojat e nderhyrjes për heqja e pllakave ekzistuese të dëmtuara dhe vendosja e pllakave të reja në ambientet e klasave, për objektin jane parashikuar punimet si me poshte :

- Heqje pllakash dysHEMEJE
- Prishje shtrese betoni
- Shtrese betoni
- Shtrese me pllaka gres porcelanato

➤ QËLLIMI I PROJEKTIT

Nisur nga verifikimet e kryera ne terren nga sektori i projektimit u parashtrua se keto objekte arsimore nuk plotesojne standartet e nevojshme per tu frekuentuar nga nxenesit aktualisht, prandaj duhet të realizojmë një projekt për rikonstruksionin e plote te tualeteve. Ambientet e tualeteve duhet të jenë konform standarteve të projektimit të parashikuara. Per kete arsye eshte parashikuar qe shkarkimet e ujrave te zeza te behen ne linje ekzistuese . Keshtu para perfundimit te punimeve duhet parashikuar qe tubacionet për ujrát e zeza të pastrohen dhe te riparohen në ato segmente që do të futen ne pune. Qëllimi i ndërhyrjes është edhe përmisimi i kushteve funksionale dhe mirëmbajtëse të objektit,

nëpërmjet realizimit të punimeve të izolimit, vendosjes së sistemit të ulluqeve për largimin e ujërave atmosferike, si dhe shtrimit me pllaka të ambienteve të klasave.

Per sa me siper bashkengjitur jane:

1. Projektet perkatese
2. Relacioni teknik
3. Specifikimet teknike
4. Preventivi i punimeve.
5. Grafiku i punimeve

Hartoi : SEKTORI I PROJEKTIMIT

Ark.Ester Toni

Ing.Teuta Tepelena

Ing. Bruno Korumi

Ing.Arian Baku

Ing.Amarildo Ahmati

Ing.Iris Musai

Konfirmoi: DREJTORI I DPU

Ark. Marvis Avllazagaj

MIRATOHET

Kryetari i Bashkise Elbasan

Gledian Llatja

